



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:291479  
Datë: 28.10.2024  
Numri i dokumentit: 06359504

**K.Dh.Shk.II.nr.507/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Rail Trans Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Terminali Doganor zyra nr.52, me autorizim e përfaqëson Naim Spahiu, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Union Sh.P.K., me seli në Vushtrri, rr. “Gjergj Fishta”, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.536/22 të datës 31.10.2023, me datë 18.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa themeltë ankesa e debitorit Union Sh.P.K., me seli në Vushtrri, rr. “Gjergj Fishta”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.536/22 të datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.536/22 të datës 31.10.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Union Sh.P.K., me seli në Vushtrri, rr. “Gjergj Fishta”, ashtu që e ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr.312/19, të datës 08.04.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Shala, sa i përket borxhit në shumën prej 3,512.00 euro dhe në këtë pjesë

të përbarimit procedura ka përfunduar, në pikën II, e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Union Sh.P.K., me seli në Vushtrri, rr. “Gjergj Fishta”, ashtu që mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përbarimor P.nr.312/19, të datës 08.04.2019, të lejuar nga Përmbauesi Privat Isa Shala, sa i përket shumës prej 10,272.60 euro.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori Union Sh.P.K., me seli në Vushtrri, rr. “Gjergj Fishta”, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.536/22 të datës 31.10.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit dhe të anulohet aktvendimi e ankimuar ose të njëjtin ta rikthej në rishqyrtim.

Përgjigje në ankesa ka parashtruar kreditori, duke kundërshtua pretendimet e debitorit dhe ka propozuar që të refuzohet ankesa e debitorit si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar KPPP.nr.536/22 të datës 31.10.2023 i Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, dhe të obligohet debitori për shpenzimet e procedurës përbarimore.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e debitori është pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Rail Trans Sh.P.K., me seli në Prishtinë, Terminali Doganor zyra nr.52, me datën 08.04.2019 ka paraqitur propozim për lejimin e përbarimit, kundër debitorit Union Sh.P.K., me seli në Vushtrri, rr. “Gjergj Fishta”, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave për shumën e borxhit prej 13,787.00 €.

Përmbauesi Privat Isa Shala, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.312/19, të datës 08.04.2019, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – -Fature nr. 134 date 08.01.2019 në vlerë prej 2,200.00 Euro, Fature nr. AUTODITE e datës 22.02.2019 në vlerë prej 2,550.00 Euro, Fatura nr.951 e datës 01.03.2019 në vlerë prej 116.00 Euro, Fatura nr. 950 e datës 01.03.2019 në vlerë prej 735.00 Euro, Faturë nr. 906 e datës 25.02.2019 në vlerë prej 42,00 Euro, Fature nr. 357 e datës 31.01.2019 në vlerë

prej 61.00 euro, Fature nr. 227 e datës 24.01.2019 ne vlere prej 775.00 Euro, Fature nr. 178 e datës 22.01.2019 ne vlere prej 430.00 Euro, Fature nr. 177 e datës 22.01.2019 në vlerë prej 430.00 Euro, Fature nr. 220 e datës 24.01.2019 në vlerë prej 350.00 Euro, Fature nr. 234 e datës 25.01.2019 në vlerë prej 570.00 Euro, Fature nr. 3586 e datës 18.10.2018 vlerë 96.00 Euro, Fatura nr. 4535 datës 31.12.2018 në vlerë 380.00 Euro, Fature nr.54 e datës 02.01.2017 në vlerë prej 770.00 Euro, Fature nr. 3545 datë 23.12.2017 në vlerë 700.00 Euro, Fature nr. 2975 e datës 28.12.2016 në vlerë prej 45.00 Euro, Fature nr. 2807 e datës 02.12.2016 në vlerë prej 720.00 Euro, Fature nr.513 e datës 02.02.2019 në vlerë prej 775.00 Euro, Fature nr. 88 e datës 12.01.2019 në vlerë prej 713.00 Euro, Fature nr.97 e datës 14.01.2019 në vlerë prej 542.00 Euro, Fature nr. 117 e datës 15.01.2019 në vlerë prej 570.00 Euro, Fature nr. 111 e datës 13.01.2018 në vlerë prej 217.00 Euro, duke urdhëruar debitorin t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 13,787.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, 01.04.2019 deri në mbylljen e borxhit në tërësi, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore duke përfshirë edhe shpenzimet e avokatit sipas rregullores për Tarifën e Avokatëve, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbarimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbarimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.536/22 të datës 31.10.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Union Sh.P.K., me seli në Vushtrri, rr. “Gjergj Fishta”, ashtu që e ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr.312/19, të datës 08.04.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Shala, sa i përket borxhit në shumën prej 3,512.00 euro dhe në këtë pjesë të përmbarimit procedura ka përfunduar, në pikën II, e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Union Sh.P.K., me seli në Vushtrri, rr. “Gjergj Fishta”, ashtu që mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbarimor P.nr.312/19, të datës 08.04.2019, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Shala, sa i përket shumës prej 10,272.60 euro. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vërejtjet e Gjykatës së Apelit Ac.nr.1534/20 të datës 10.12.2021, gjeti se Urdhri përmbarimor P.nr.312/19, të datës

08.04.2019, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori dhe atë në lartësi prej 3,512.00 euro, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë pjesë debitori e ka përmbushur detyrimin. Përkatësisht, gjykata gjen se Fatura nr. 227 të datës 24.01.2019 në vlerë prej 592.00 euro është paguar pjesërisht (pra me datën 27.02.2019, ka mbet pa paguar shuma 183.00 euro), Fatura Nr.134 të datës 08.01.2019 në vlerë prej 2,200.00 euro është paguar me datën 20.02.2019 dhe Fatura Nr.2807 në shumë prej 720.00 euro është paguar me datën 29.12.2019, të gjitha këto në shumë totale prej 3,512.00 euro, pra kjo gjendje vërtetohet nga përgjigja në prapësim të kreditorit dhe nga kartela financiare e dorëzuar nga kreditori. Gjykata meqenëse debitori ka përmbushur pjesërisht borxhin, bazuar në nenin 66, par. 4 të LPP-së ka përcaktuar se : *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”* dhe nga nenin 12 i LPP-së Nr.05/L-118 ku përcakton se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*. Në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrit P.nr.312/19, të datës 08.04.2019, për shumën në vlerë prej 10,275.00 euro, dhe atë sipas - Fature nr. AUTODITE e datës 22.02.2019 në vlerë prej 2,550.00 Euro, Fatura nr.951 e datës 01.03.2019 në vlerë prej 116.00 Euro, Fatura nr. 950 e datës 01.03.2019 në vlerë prej 735.00 Euro, Faturë nr. 906 e datës 25.02.2019 në vlerë prej 42,00 Euro, Fature nr. 357 e datës 31.01.2019 në vlerë prej 61.00 euro, Fature nr. 227 e datës 24.01.2019 ne vlere prej 775.00 Euro, Fature nr. 178 e datës 22.01.2019 ne vlere prej 430.00 Euro, Fature nr. 177 e datës 22.01.2019 në vlerë prej 430.00 Euro, Fature nr. 220 e datës 24.01.2019 në vlerë prej 350.00 Euro, Fature nr. 234 e datës 25.01.2019 në vlerë prej 570.00 Euro, Fature nr. 3586 e datës 18.10.2018 vlerë 96.00 Euro, Fatura nr. 4535 datës 31.12.2018 në vlerë 380.00 Euro, Fature nr.54 e datës 02.01.2017 në vlerë prej 770.00 Euro, Fature nr. 3545 datë 23.12.2017 në vlerë 700.00 Euro, Fature nr. 2975 e datës 28.12.2016 në vlerë prej 45.00 Euro, Fature nr.513 e datës 02.02.2019 në vlerë prej 775.00 Euro, Fature nr. 88 e datës 12.01.2019 në vlerë prej 713.00 Euro, Fature nr.97 e datës 14.01.2019 në vlerë prej 542.00 Euro, Fature nr. 117 e datës 15.01.2019 në vlerë prej 570.00 Euro, Fature nr. 111 e datës 13.01.2018 në vlerë prej 217.00 Euro, për faktin se faturat në bazë të se cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës

– Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të pjesshëm të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar si në pikën I të dispozitivit, ku Faturat e lartë cekura janë përmbushur nga debitorit dhe kjo nuk kundërshtohet as nga kreditori. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga neni 66 par. 4 i LPP, i cili përcakton se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”* dhe nga nenin 12 i LPP-së Nr.05/L-118 ku përcakton se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, prandaj ka vendosur drejt duke përfunduar procedurën përmbarimore për detyrimin në vlerë prej 3,512.00 euro. Gjithashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë dhe saktë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur ka vendosur si në pikën, II të dispozitivit me të cilën ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.312/19, të datës 08.04.2019, për shumën në vlerë prej 10,275.00 euro, pasi që këto fatura të lartëcekura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.1 të LPP-së ku përcakton se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa para. 3 përcakton se :*“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, pra janë treguar palët, mallrat/shërbimet që janë objekt i këtyre faturave dhe të gjitha elementet nga këto dispozita të LPP-së. Gjithashtu sipas nenit 37 të LPP-së përcaktohet se : *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, pra këto dokumente përmbarimore gjegjësisht faturat janë të pranuar nga ana e debitorit përmesë fletëkthesës së postës Koex me numër

364769 e datës 12.03.2019, dhe të cilat debitori nuk i ka kundërshtuar në afatin ligjor, andaj dhe janë plotësuar kushtet për përmbarim ashtu sipas dispozitave të lartë cekura.

Andaj bazuar në të lartë cekurat, dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të debitorit lidhur me pretendimin e tij se faturat në fjalë nuk janë të pranuar nga debitori, gjykata vlerëson se pretendimet e tilla janë të pabazuara ngase faturat në fjalë janë të pranuar përmesë fletëkthesës së postës Koex me numër 364769 e datës 12.03.2019 dhe të cilat i njëjti nuk i ka kundërshtuar me rastin e pranimit përmesë postës, kështu në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Andaj, nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**

K.Dh.Shk.II.nr.507/24 dt. 18.10.2024

Gjyqtarja

Franciska Zhitija Ymeri